

ORGANET KOMPETENTE PËR REGJISTRIM TË PRONËS

Bazuar në ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, organe kompetente për regjistrimin e të drejtave pronësore janë Zyrrat Kadastrale Komunale, ndërsa Agjencia Kadastrale e Kosovës është organ i nivelit qendror i shkallës së dytë, në cilësinë e organit për ankimim.

LLOJET E TË DREJTAVE PRONËSORE PËR REGJISTRIM

Procedurat për aplikim dhe regjistrim të të drejtave pronësore dallojnë varësisht të drejtës që regjistrohet, e ato janë si vijojnë:

- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË SHITBLERJEJE,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME AKTVENDIM TRASHËGIMIE,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË DHURIMI,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË KËMBIMI,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME KONTRATË SHITBLERJEJE ,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME VENDIM GJYQSORË,
- REGJISTRIMI I PRONËSISË ME VENDIM NGA ORGANET TJERA KOMPETENTE,
- REGJISTRIM I PRONËSISË ME KREDITIM APO HIPOTEKË,
- BARTJE E PRONËSISË ME KONTRATË PËR NDËRTIM/KOMPENSIM,
- BARTJE E PRONËSISË NË BAZË TË PRANIMIT,
- REGJISTRIM I KONTRATËS ME MBAJTJE TË PËRHERSHME.

PRONËSIA ËSHTË E DREJTA E TËRËSISHME NË NJË SEND

Pronari mund të disponojë pronën e tij sipas dëshirës së tij, nëse kjo nuk kundërshtohet nga një palë e tretë ose nga ligji.

Për bartjen e të drejtës mbi paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme e ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. Vetëm atëherë mund ta vërtetohet pronësia me anë të certifikatës së pronësisë.

Bazuar në këtë që u tha më sipër llojet e bartjes së të drejtës së pronësisë që regjistrohen në SIKTK janë:

- BLERJA,
- TRASHËGIMIA,
- DHURIMI,
- KËMBIMI,
- NDARJA FIZIKE,
- SHPRONËSIMI,
- VENDIM GJYQËSOR,
- VENDIM NGA ORGANET KOMPETENTE,
- KREDITIM/HIPOTEKË,
- NDËRTIM/KOMPENSIM,
- NË BAZË TË PRANIMIT DHE
- MBI MBAJTJEN E PËRJETSHME.

Agjencia Kadastrale e Kosovës
Rr: "Arbnor dhe Astrit Dehari" Nr. 25
10000
Pristinë
Republika e Kosovës



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Katastarska Agencija Kosova
Kosovo Cadastral Agency

PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME NË KADASTËR



REGJISTRIMI I SË DRJTËS SË QIRASË



PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTËS SË QIRASË

E drejta e qirasë regjistrohet në regjistër si ngarkesë, për qiradhënësin, ndërsa si e drejtë për qiramarrësin. Regjistrimi i qirasë përfshinë: emrin, numrin identifikues dhe adresën e qiramarrësit, dhe nëse qiramarrësi është person juridik, numrin identifikues të biznesit nga regjistri i biznesit dhe adresën e selisë së biznesit dhe afatin e qirasë.

E drejta e qirasë si e drejtë në paluajtshmëri parashihet në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore. Kjo e drejtë rregullohet edhe me Ligjin për Detyrimet, ku parashihet kontrata e qirasë, si kontratë e veçantë, e njohur nga ky ligj.



DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTËS SË QIRASË

Lidhja e kontratës së qirasë mund të bëhet tek noteri apo në gjykatën përkatëse, në komunën ku ndodhet prona. Qiramarrësi dhe qiradhënësi duhet që para noterit apo në gjykatë të prezantojnë dokumentet e mëposhtme:

- DOKUMENTIN E IDENTIFIKIMIT (KOPJE),
- CERTIFIKATËN E PRONËSISË (ORIGJINAL DHE JO MË E VJETËR SE GJASHTË (6) MUAJ) DHE
- KOPJEN E PLANIT (ORIGJINAL DHE JO MË E VJETËR SE GJASHTË (6) MUAJ).

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM NË ZYRËN KADASTRALE KOMUNALE

Pas marrjes së kontratës të vërtetuar tek noteri apo gjykata, me qëllim të ekzekutimit të saj në kadastër, pala duhet të kompletojë dokumentacionin si më poshtë:

- NJË KOPJE TË KONTRATËS / VENDIMIT PËR QIRANË TË NOTERIZUAR,
- DOKUMENTIN E IDENTIFIKIMIT (KOPJE),
- CERTIFIKATËN E PRONËSISË (KOPJE),
- KOPJEN E PLANIT (KOPJE),
- DËSHMINË E PAGESËS SË TARIFËS PËR REGJISTRIM DHE
- DOKUMENTE TJERA SHITESË (NËSE KËRKOHEN NGA ZKK, SI P.SH. TATIMI NË PRONË)